

2 Shkëmbimi automatik i të dhënave tatimore Vetëkallzimi është i mundur në disa Kantone

3 Ligji i ri për marrjen e shtetësisë Rregulla të reja natyralizimi nga janari 2018

4 Marrëveshja për pensione me Zvicrën vonohet Vazhdon diskriminimi i kontributpaguesve nga Kosova

Nr. 1 | shkurt 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch



Manifestimi spontan ku delegatet kërkuar ndërmarrja e masa ve për jetësimin e barazisë në paga

Lohngleichheit.
Punkt. Schluss!

UNIA

Editorial



Të dashur/a lexues/e

Edhe sivjet Unia përballet me sfida të mëdha, të cilave duhet tu përvishemi bashkërisht. Në qendër të vëmendjes kemi barazinë në paga, më shumë mbrojtje për punëmarrësit si dhe negociatat e rëndësishme për KKP-të. Viti 2018 do të jetë një vit i rëndësishëm për barazinë. Më në fund do të duhet kujdesur që punëdhënësit në të ardhmen të respektojnë barazinë në paga, ashtu si është paraparë me kushtetutë të vendit që gati 40 vite. Partitë e djathta borgjeze dhe punëdhënësit kundërshtojnë furishëm çfarëdo lloj përmirësimi ligjor. Me demonstratën e madhe të përbashkët nacionale në vjeshtë të këtij viti ne duam për ketë arsye të ushtrojmë presion – Barazi në paga. Pikë. Përfundimisht.

Në ndërtimtarit shoqata punëdhënësve kundërshton rritjen e pagave, ata duan të rrisin orarin e punës në 50 orë dhe sulmojnë rregullimin përparimtar dhe social për pensionim me 60 vjet. Këtë sulm të madh do ta kundërshtojmë me demonstratën e madhe nacionale në qershor dhe nëse është e nevojshme edhe e grevë. Negociatat për KKP në industrinë e makinerive ne angazhohemi për paga më të larta minimale dhe luftojmë planin e punëdhënësve për zgjatjen dhe fleksibilizimin e orarit të punës. Politikanët e djathtë borgjez dhe punëdhënësit i fryjnë buxhetin për sulm dhe marrin digitalizimin si shkas për të përkeqësuar kushtet e punës. Ata sulmojnë Kontratën tonë të madha Kolektive të Punës deri edhe vet Ligjin e Punës (orari të shtuar të punës, më shumë fleksibilitet) dhe refuzojnë paga të drejta për gratë. Ndërsa përfundimisht nevojitet më shumë mbrojtje për punëmarrësit nga ndikimet e globalizimit dhe më shumë drejtësi sociale. Për keto angazhohemi ne bashkërisht!

Corinne Schärer, Unia GL Mitgleid

Kongresi i grave 2018

Barazia në paga: Parlamenti është sfiduar të veproi

Edhe pse në Kushtetutë që 37 vite është i shkruar dhe vlen parimi «pagë e njëjtë për punë të njëjtë», gratë në Zvicër edhe më tej fitojnë më pak se sa burrat. Edhe 22 vite pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Barazi është koha e fundit që të veprohet. Tani më duhet të veproi Parlamenti.

Mbi 200 gra dhe disa burra solidarizues të shtunën e 19 janarit 2018 përmes një manifestimi spontan kanë kërkuar nga Parlamenti që me rastin e revidimit të Ligjit mbi Barazinë të ankorojë masa ndikuese për realizimin e barazisë në paga.

Kontrollet dhe bashkëpunimi i sindikatave

Federata duhet të kontrollojë, se a i realizojnë ndërmarrjet në mënyrë korrekte analizat e tyre dhe a e respektojnë ato barazinë në paga. Firmat, të cilat diskriminojnë gratë duhet të sanksionohen me ligj. Ndërsa sindikatat duhet që me krijimin e komisioneve të përbashkëta në nivel federate të mund të ndikojnë mbi zbatimin e barazisë në paga.

Kongresi i 13-të i BSZ: «Koha jonë ka më shumë vlerë»

Rreth 240 delegate të Bashkimit të

Sindikatave të Zvicrës (BSZ) në kongresin e tyre në Bernë kanë kërkuar që punë më të shkurtër, më të mirë dhe më drejtë të paguara. Përmes një aksioni spontan në sheshin e teatrit në Bernë, gratë e BSZ-së që në ditën e parë të kongresit, kur është zhvilluar edhe mbledhja e Komisionit përgjegjës të Këshillit federal të dhomave të Kantoneve, kanë kërkuar nga Parlamenti hapa më të guximshëm në lidhje me pagat e njëjta. Është koha e fundit që të respektohet kushtetuta. Nevojitet «Paga të njëjta. Pukë. Përfundimisht!».

Si të rëndësishme sindikalistët diskutuan edhe mbi temat e punës së kujdesit dhe orarit të punës. Ata kritikuan faktin që punëdhënësit edhe pse ftojnë gratë si profesioniste, njëkohësisht rrezikojnë ofertat e përkujdesjes publike me veprime kursyese. Sociologja Sarah Schilliger në referatin e saj tregoi se si gratë

provojnë të mbyllin zbrazësitë. Ata janë të detyruara të pranojnë punësim me orar të pjesshëm, punësim ky i cili më vonë me rastin e pensionimit si pasojë hakmerret me një siguri të dobët sociale.

Gratë e kongresit të BSZ-së shtrojnë kërkesa

Puna e mirë e përkujdesjes, për të cilën fëmijët, të moshuarit dhe të sëmurët kanë të drejtë, por e cila punë kërkon kohë dhe burime të mjaftueshme financiare dhe kushte korrekte pune. Andaj gratë e BSZ-së përmes një rezolute kërkojnë që puna e paguar e përkujdesjes të jetë pjesë e shërbimeve publike dhe si e tillë duhet të jetë e qasshme për të gjithë, edhe atë si me cilësi ashte edhe me vlerë të lartë si dhe të financuar publikisht mjaftueshëm. Kushtet punës në përkujdesje në amvisnit private duhet ti nënshtrohen ligjit të punës edhe për të sh-

mangur kështu parregullsitë. Puna e papaguar e përkujdesjes duhet të njihet si veprimtari pune dhe të merret parasysh mjaftueshëm edhe në sigurimet shoqërore.

Më tej gratë e BSZ-së kërkojnë shpërndarjen më të drejtë të punës së paguar dhe asaj të papaguar me grave dhe burrave. Për këtë nevojitet orar më i shkurtër i punës. Suedia përmes pilot projekteve këtij synimi iu është afruar një hap më afër, siç sqaroi në referatin e saj Elinor Odeberg nga sindikatat komunale suedeze. Në afatgjatë gratë e BSZ-së synojnë një javë pune prej 35 orësh. Në afatshkurtër duhet që të kundërshtohen dhe luftohen në mënyrë të vendosur sulmet mbi ligjin e punës dhe rritja e orarit të punës si dhe hiqja e orarit të kufizuar të punës (heqja e evidentimit të orarit të punës dhe zgjerimi i punës natën dhe të dielave). Pos kësaj gratë kërkojnë orar pune më dashamirës për familjet dhe orare të planifikuara pune.

Osman Osamani

News

Personeli i ABB-së kërkon negociata të reja

Personeli i ABB Sécheron në Gjenevë kërkon nga drejtorja e firmës bisedime mbi zhvendosjen e prodhimit në Poloni. Disa propozime përmirësuese, të cilat veçanërisht i kanë përpunuar rreth 100 të punësuar në një konsultim gjashtë ditësh në muajin nëntor, janë aprovuar. Hapësira kohore, në të cilën duhet të ndodhë zhvendosja, falë presionit të të punësuarve është zgjatuar në 24 muaj. Kjo domethënë, se në vitin 2018, edhe përkundër planifikimeve, nuk do të ketë shkarkime nga puna. Mirëpo përgjigja e ndërmarrjes në procedurën konsultative mbetet shumë mbrapa pritjeve të të punësuarve.



Fitore për grevistët në Rennanz

Grevistët e kantierit të spitalit Riviera-Chablais in Rennanz (VD) që nga 18.12.2017 kanë fituar: Ata bashkë me sindikatën Unia arritën të sigurojnë kompensimin për drekë në shumën prej 30 000 frangash dhe sigurimin e vendeve të punës deri në mars të vitit 2018. Grewa përfundoi suksesshëm, me çka punonjësit morën paratë e tyre dhe mbrojtjen dinjitetin e tyre.



FAIRLOG: aleancë e re sindikaliste për transport dhe logjistikë

Kushtet e punës në transportin rrugor të mallrave dhe në logjistikë duhet urgjentisht të përmirësohen. Përgjigja e sindikatave quhet: FAIRLOG – dhe domethënë një mundësi të mirë të arsimimit profesional dhe trajnimit të mëtejshëm. Gjithashtu qendrore është se nuk duhet shmangur nga rregullat mbrojtëse që vlejnë në Zvicër. Rregullat sikur limiti 40 tonësh, ndalesa për punë natën dhe të dielave, ndalimi i kabotazhit dhe parimi i pagave zvicerane në rrugët zvicerane duhet mbrojtur në interes të punëmarrësve.



Petizioni «Zolando» për kushte korrekte të punës

Të punësuarit e «Zolando» në Zvicër vuajnë nga kushtet misërie të punës. Pagë e ulët për orë pune, punë sipas nevojës, kontrata të kufizuara të punës dhe presion masiv kohor i takojnë mjerisht përditshmërisë. Andaj, Unia ka nisur një peticion, përmes të cilit kërkon që «Zolando» e Zvicrës për firmat saja furnizuese të garantojë kushte korrekte të punës dhe një pagë ore pre së paku 22 frangave në orë.

Shkëmbimi automatik i të dhënave tatimore Vetëkallëzimi është i mundur vetëm në disa nga kantonet

Shkëmbimi automatik i të dhënave tatimore (AIA) fillon të zbatohet sivjet për herët të parë. Datat relevante tatimore në vjeshtë do të dërgohen në 38 shtete – dhe anasjelltas do të merren nga të gjitha këto shtete. Në vitet e ardhshme këtyre shteteve do tu shtohen edhe shtete tjera. Çka domethënë kjo për migrantët në Zvicër?

Gjithnjë e më shumë shtete shkëmbejnë mes veti informatat mbi kontot bankare dhe të dhënat e sigurimeve të detyruesve tatimor, të cilët kanë vendbanimin në botën e jashtme. Automatikisht domethënë, që këto të dhëna grumbullohen dhe dërgohen pa kërkesë. Autoritetet tatimore zvicerane pra do të marrin të dhëna mbi pasurinë dhe të ardhurat, të cilat obliguesit tatimor në Zvicër i posedojnë jashtë vendit.

Domethënia për paguesit tatimor të Zvicrës

Bazuar në ligj obliguesit tatimor në Zvicër duhet të deklarohen në formularët tatimor të gjitha të ardhurat, pasurinë dhe borxhet, pra edhe ato jashtë Zvicrës. Shumë obliguesit tatimor nga Zvicra, para së gjithash migrante e migrantë, nuk e kanë ditur këtë, andaj edhe nuk e kanë deklaruar. Ata paguajnë në vendet e tyre të origjinës taksa, andaj shumë nga ta nisur nga ky fakt mendojnë se kanë përmbyshur obligimet e tyre. Në realitet, kur ekziston një marrëveshje për mënjanimin e tatimit të dyfishtë, nuk duhet paguar tatim për të ardhura dhe patundshmëri në vendet tjera, mirëpo këto nevojiten për të llogaritur normën e tatimit. Kështu që, mos deklarimi sipas ligjeve zvicerane konsiderohet vepër fajësie për shmangie tatimi (evazion fiskal).

Çka duhet bërë, nëse nuk është deklaruar asgjë?

Ligji zviceran për tatim parasheh mundësinë e vetëkallëzimit. Për këtë paguesit e tatimit, të cilët nuk kanë deklaruar, duhet që vlerat e padeklaruar të dhjetë viteve të fundit ti japin me vetë iniciativë. Në këtë rast duhet të paguhet më pas taksat e mbetura për 10 vitet e fundit bashkë me interesin e përcaktuar (kamatën), me ç' rast nuk gjohet dhe nuk bartin konsekuenca penale. Afatet për vetëkallëzim që ndërlidhet me AIA (shkëmbimin automatik të informatave) janë të rregulluara në nivelin kantonal dhe vetëkallëzimi është i mundur në disa nga kantonet e Zvicrës (shih kornizën).

Për çdo rast vlen: Posa autoritetet tatimore zvicerane posedojnë lajmërimin, atëherë nuk mund të përfitohet nga mundësia e vetëkallëzimit pa pasojë penale. Kush posedon vlera të pataksuara, atëherë ose nuk ka mundësi të deklarojë pa pasojë penale apo të tillëve nuk u ka mbetur shumë kohë për këtë gjë.

AIA me vende tjera

Në 2018 hynë në fuqi AIA me vendet tjera, Argjentinën, Brazilin, Lichtenstein, Zelandën e Re, dhe shumë vende të tjera. Lista complete e vendeve mund të shihet këtu: <https://www.sif.admin.ch/sif/de/home/themen/informationsaustausch/automatischer>

[informationsaustausch/automatischer-informationsaustausch1.html](https://www.sif.admin.ch/sif/de/home/themen/informationsaustausch/automatischer.html). Kështu mundësia e vetëkallëzimit të të dhënave financiare edhe për këto vende do të kufizohet.

Nëse keni pyetje sqaruese, sindikata Unia është në dispozicion. Lajmërohuni në sekretariatit tuaj, apo tek përmes postes elektronike në migration@unia.ch.


Marília Mendes

Vetëkallëzimi: Afatet

Disa kantone pranojnë vetëkallëzimin, deri në kohën kur autoritetet tatimore të zbulojnë evazionin fiskal. Mirëpo, për të mos rrezikuar, secili që posedon vlera të pataksuara, do të duhet të veprime menjëherë. Në shumë kantone nuk është i mundur vetëkallëzimi që ndërlidhet me AIA, e i cili ka hy në fuqi në vitin 2017. Mirëpo shumë kantone nuk kanë njoftuar mbi afatet. Për të qenë të sigurtë, ia vlen të pyetet kantoni.

Kantonet vijuese pranojnë vetëkallëzimin deri me 30.09.2018:

Appenzell Innerrhoden, Appenzell Ausserrhoden, Bern, Baselland, Baselstadt, Glarus, Graubünden, Luzern, Obwalden, St. Gallen, Schaffhausen, Solothurn, Thurgau, Tessin, Waadt, Wallis, Zug und Zürich



Grafika që pasqyron shkëmbimin e të dhënave tatimore

Përkujdesja dhe mbështetja Senevita-shtëpitë e pleqve të ndaluara

Ashtu sikur ka kuptuar edhe reportazhi «Rundschau» i televizionit publik zviceran SRG, i cili gjatë xhirimit rreth situatës në shtëpinë pleqve Senevita morri vesh se në kohën e fundit shumë persona kanë dhënë dorëheqje nga shtëpia e pleqve në Pratteln, në mes të tre edhe një i përkujdesur në moshë, të cilët i ka shoqëruar dhe intervistuar. Paraprakisht emisionit «Rundschau» i kishin arritur shumë akuza nga ish të punësuarit dhe nga ata aktual të shtëpive të pleqve Senevita.

Kritika drejtuar Senevita vjen më së shumti nga shtëpitë e pleqve, të cilat janë hapur kryesisht në vitet e fundit. Që nga viti 2014 rrjeti Senevita është rritur nga 13 në 25 shtëpi pleqsh – dhe tanimë është ofruesi i dytë privat për nga madhësia në Zvicër. Senevita fillimisht ishte krijuar nga një zviceran dhe në vitin 2014 ishte blerë nga korporata franceze e përkujdesjes Orpea. Kjo është njëra ndër lojtarët më të mëdhenj në tregun e përkujdesjes në tërë botën.



Protesta e personelit dhe të përkujdesurve

Orpea në tregun financiar ka një kapitali në vlerë prej mbi 7 miliardë franga zvicerane. Në vitin 2016 vëllimi i shitjes i Orpea ishte 2,8 miliardë euro. Korporata është fort e përqendruar në rritjen e kapitalit dhe aktualisht operon në dhjetë vende në Evropë dhe Kinë. Në Zvicër përnjëherë ka hapur disa shtëpi pleqsh, që kur Orpea është bërë pronare e Senevita.

Kundër bërjes së profitit dhe për kushte më të mira pune

Qysh vitin e kaluar Unia ka kërkuar: Krijimin e një atmosfere, në të cilën të përkujdesurit dhe banorët/et e shtëpive të pleqve të ndihen mirë, krahas kushteve të rregulluara të punës nevojiten dhe më shumë personel edhe gatis-hmëri të punëdhënësit për një dialog partneriteti social.

Unia ka kohë që kundërshton sjelljen e padinjitetshme me personelin, nevojtarët e përkujdesur dhe familjarët e tyre nëpër shtëpitë e pleqve të grupit Senevita. Sindikata kritikon synimin përfitues në kurriz të personelit dhe të nevojtarëve për përkujdesje dhe kërkon më shumë investime në njerëz, se sa në përfitim. Në majin e vitit të kaluar Unia përmes një aksioni të e-mailëve protestues kërkoj nga shtëpitë e pleqve Senevita të ndryshojë menjëherë gjendjen e padurueshme. Mirëpo mungoi reagimi i drejtorisë. Në muajt e fundit pot tjerash janë lajmëruar shumë familjarë të merakosur sikur të ish punonjësve ashtu edhe të atyre aktual në Senevita dhe kanë bërë ankesat e tyre.

Osman Osmani

Ligji i shtetësisë 2018 Rregulla të reja të natyralizimit nga janari 2018

Që nga fillimi i vitit vlejnë rregulla të reja për marrjen e shtetësisë zvicerane. Si bazament vlen ligji i ri mbi shtetësinë, i cili ka hyrë në fuqi që nga 1 janari. Në këtë ligj janë numëruar kriteret e integritimit. Kushdo që donë të bëhet zviceran, nuk mjafton vetëm njohja e mjaftueshme e njërës nga gjuhët zyrtare të vendit. Pos tjerash duhet të respektoji vlerat e kushtetutës federale.

Sipas udhëzimit zyrtar mbi ligjin vlen edhe obligimi për shkollim. Me këtë edhe pjesëmarrja obliguese në lëndën e notit, e cila me planin mësimor 21 është i detyrueshëm në të gjitha kantonet germano folëse.

Rishtas rregulla të ashpra natyralizimi

Në risitë e përcaktuara nga federata është edhe leja e përhershme (C) e qëndrimit si parakusht për të aplikuar për shtetësi. Disa lehtësira megjithatë janë sa i përket afateve të banimit.

Rishtas paraqet një pengesë marrja e ndihmës sociale për tu natyralizuar. Kjo mund të tejkalohet vetëm në rast se tri vite para aplikimit për marrje shtetësie kthehet shumae ndihmës së marrë sociale.

Në të ardhmen të huajt që janë dënuar penalisht do të duhet të presin më gjatë për marrje shtetësie. Aplikimi mund të bëhet tek pasi të jetë shlyer emri i të dënuarit nga regjistri penal.

Lehtësime natyralizimi për gjeneratën e tretë

Nga mesi e shkurtit të huajt e moshës së re të gjeneratës së tretë, familjet e të cilëve jetojnë me gjenerata në Zvicër dhe të cilët janë të integruar mirë këtu, mund të natyralizohen me procedurë të lehtësuar. Qeveria federale në mbledhjen e saj të 17 janarit 2018 ka aprovuar ndryshimin gjegjës dhe ka vendos ta fuqizoj atë me 15 shkurt 2018. Parakushte tjera janë: Njëri prindër duhet të ketë qëndruar së paku 10 vite

në Zvicër, të ketë vizituar së paku 5 vite të shkollimit obligues dhe të posedojnë lejen e përhershme (C) të qëndrimit; njëri nga gjyshërit duhet të ketë pasur leje qëndrimi, apo të ketë lindur këtu. E drejta e qëndrimit duhet të dëshmohet e vërtetohet me dokumentet zyrtare.

Tom Cassee



Aksione nga e kaluara për lehtësim natyralizimi

Më shumë mbrojtje për personelin e shitoreve të karburanteve Më shumë përmirësime falë KKP-ve

Qeveria federale ka shpallur si detyrim të përgjithshëm Kontratën Kolektive të Punës (KKP) për shitoret e karburanteve. Që nga 1 shkurti 2018 vlejnë pagat minimale si dhe rregullat tjera të detyrueshme për rreth 13 000 punëmarrës.

KKP e re mbron kushtet e punës të të punësuarve në shitoret e karburanteve dhe me veti sjell përmirësime të shumta. Krahas përcaktimit të pagës minimale rregullon KKP-në e veçanërisht orarin e punës dhe garanton një mori të përfitimeve sociale, si pushimin e atësisë, vazhdimin e pagës në rast sëmundjeje dhe lehonie.

Tiçinoja pjesërisht e përjashtuar

Për të punësuarit në Tiçino edhe pse më në fund vlen KKP-ja për shitoret e karburanteve, mirëpo jo edhe rregullat për pagën minimale. Kjo, edhe përkundër faktit se të punësuarit në fjalë në Tiçino janë të prekur veçanërisht nga dumpingu

në paga. Unia shpreh keqardhje për vendimin e Qeverisë Federale në këtë drejtim dhe së bashku me palët e tjera kontraktuese, do të përpiqet të gjejë një zgjidhje edhe për Tiçinon.

Një premierë në sektorin e shitjes me pakicë

Në nëntor të vitit 2015 partnerët social përmbyllën suksesshëm bisedimet mbi një KKP të re për shitoret e karburanteve. Që atëherë pritej vendimi i autoriteteve federale. KKP e re për shitoret e karburanteve është e para Kontratë Kolektive e Punës e shpallur me detyrim të përgjithshëm në sektorin e shitjes me pakicë. Informata të detajuara mbi KKP-në e re, si fjala bie vlefshmëria e pagës minimale në kantonet e ndryshme, rregullimi për pushimet vjetore, festat dhe orarin e punës, etj., mund të kërkojnë tek Unia.

Maria Montaña Martin Burdalo



Përmirësime e kushteve të punës në shitoret e karburanteve

Intervistë

Sascha Hardegger

Jo sulmit kundër demokracisë – Jo për «No Billag»!

Me 4 mars votueset e votuesit zviceran do të votojnë mbi iniciativën e ashtuquajtur «No Billag». Iniciativa do të kishte ndikim të madh mbi mediat publike zvicerane dhe bile do të prekeshin edhe mediat e migrantëve. Horizonte ka biseduar me Sascha Hardegger, drejtuesin e ri të sektorit të fushatave dhe komunikimit në sindikatën Unia.

Sascha, çka saktësisht thotë iniciativa «No Billag»?

Qëllimi i iniciativës është zhbërja e tërësishme e shërbitimit publik në lëmin e mediave – dhe kështu paraqet sulm të drejtpërdrejtë mbi demokracinë tonë. Me JO kundër No Billag Unia angazhohet për ruajtjen ligjore të mediave publike, për mbështetjen e ndërsjellët kulturore të regjioneve gjuhësore si dhe lirisë së informimit. Një demokraci e gjallë ka nevojë për peizazhin e mediave të pavarura.

Iniciatorët thonë se fjala është vetëm për taksat dhe se media publike do të ketë edhe më tej. A nuk qëndron kjo kështu?

Jo, kjo nuk është korrekte. Iniciativa nuk është një «jo» e zemëruar kundër taksave të Radios e Televizionit, ashtu siç pretendohet të inskenohet – por pasojat janë me ndikim shumë më të gjerë. Pa taksa varfërohet peizazhi i mediave, si gur themel i rëndësishëm i demokracisë sonë. Për Zvicrën italiane, Zvicrën perëndimore, si dhe Retoromanet/ët, do të thoshte fundi i emetimit programor.

Çfarë roli luan se a janë mediat publike apo private?

Vetëm mediat publike të «Service Public» (shërbimit publik) janë të obliguara të pasqyrojnë shumëllojshmërinë e mediave. Kjo është absolutisht e nevojshme për demokracinë e gjallë. Si pasojë do të kishim – formuluar shkajshmërisht – vetëm Blocher-TV, apo Bigler-TV. Pasi: Kush ka para, mund ta drejtojë e shpërndajë informatën dhe të blejë mendimin publik. Kjo do të ishte një dëftesë varfërie në vend të demokracisë së gjallë.

Dhe çka domethënë kjo për punëmarrësit në mediat publike?

Humbësit/et para së gjithash do të jenë të punësuarit e SRG (televizionit publik zviceran), në TV-të e Radiot lokale dhe familjarët e tyre. Gjithsejtë janë 14000 vende pune të rrezikuara. Edhe regjionet anësore kufitare do të prekeshin. Dhe për të gjithë që kanë një punë në sektorin e mediave, kushtet punës do të përkeqësoheshin: Mirëpo jo vetëm kushtet e jetesës së profesionistëve të mediave janë rrezikuar. Edhe muzikantët/et, aktorët/ët dhe profesionistët tjerë kulturor do të prekeshin.

Çka nuk do të ketë më, kur të privatizohen mediat?

Ashtu si u tha më herët: shumë radio lokale dhe stacione televizive do të bankrotonin dhe emisionet e SRG (TV-ja publike zvicerane) do të zhdukeshin. Njerëzit me shumë para dhe ndikim do ta formatonin peizazhin e mediave dhe kështu tërthorazi do të blinin mendimin publik Dhe për të mos harruar: Për informim të pavarur ne do të duhej të futnim dorën edhe më thellë në gjepa.

Mirëpo shumë migrante e migrantë shohin dhe lexojnë para së gjithash mediat e vendeve amë. Iniciativa nuk i prek ata, apo?

Nga iniciativa janë të gjithë të prekur. Në njërin anë demokracia dhe shumëllojshmëria e mendimeve janë qendrore për demokracinë funksionale, të cilës i takojnë edhe migrantët/ët. Në anën tjetër shumë radio lokale, mendojë për shembull Radio Lora në Cyrih, apo Radio Rabe bë Bernë, kanë programe speciale për migrantët/e, në gjuhët e tyre amtare. Swissinfo informon në shtatë gjuhë tjera pos atyre zyrtare gjermane, frëngjishte dhe italishte. Të gjitha këto nëse aprovohet iniciativa nuk do ti kemi më tej.

Marilia Mendes

Punëdhënësit e ndërtimtarisë sulmojnë frontalisht kushtet e punës

Situata në ndërtimtarinë është serioze. Në fund të vitit përfundon KKP dhe duhet të re negociohet. Në vend se të merr seriozisht kërkesat e punëtorëve të ndërtimtarisë, shoqata e punëdhënësve planifikon një sulm radikal kundër kushteve të punës. Konkretisht ata kërkojnë reduktim të pensionimit të hershëm dhe orar më të gjatë të punës për pagë më të ulët. Kjo tregon: në 2018-tën në ndërtimtarinë bëhet fjalë për gjithçka.

Shifrat tregojnë qartas: Dega e ndërtimtarisë i ka punë edhe më tej shumë mirë. Falë punës së punëtorëve të ndërtimtarisë ndërmarrjet arrijnë fitime të mëdha. Më këtë rast puna në ndërtimtarinë bëhet gjithnjë më e vështirë dhe stresi sa vjen e rritet. Në vend se kjo të vlerësohet, shoqata e punëdhënësve (SBV) që 4 vjet refuzon rritjen e pagave.

Jo vetëm kaq: Tani kryetari i punëdhënësve Gian-Luca Lardi kërkon reduktim masiv të Kontratës Kombëtare të Punës për ndërtimtarinë. KKP për ndërtimtarinë duhet të negociohet rishtas deh në të Lardi dëshiroj paga më të ulëta për shëgjertët, ulje pa-

gash për punëtorë të moshuar të ndërtimtarisë shkak i «mungesës së performancës» dhe 50-orë pune në javë për të gjithë. Edhe pensionimin me 60 vjet SBV e vënë në pikëpyetje. Ata kërkojnë moshë pensionimi me 62 vjet ose 30% më pak pension!

Të bashkuar dhe të gatshëm për luftë

Në 2018 në ndërtimtarinë është fjalë për gjithçka. Ne duam jo vetëm të kundërshtojmë sulmin e punëdhënësve dhe të mbrojmë KKP-në ekzistuese, por të arrijmë urgjentisht përmirësimet e nevojshme. Për të arritur këtë neve na nevojiten të gjithë! Me 24 shkurt takohen punëtorët e ndërtimtarisë nga

e tërë Zvicra në Olten në konferencën e degës së ndërtimtarisë, për të nisur fushatën e përbashkët. A do të jesh edhe ti aty? Për konferencën e ndërtimtarisë ti mund të lajmërohesh në regjionin tënd, apo përmes bau@unia.ch

Lena Frank



Pamje nga protesta e punëtorëve të ndërtimtarisë

Ratifikimi i vonuar i marrëveshjes për sigurime shoqërore – vazhdon diskriminimin e punëtorëve mërgimtarë

Mijëra kosovarëve që kanë punuar në Zvicër, por janë rikthyer në vendin amë, ende vazhdojnë t'iu mohohet e drejta në pensionet e tyre të pleqërisë, derisa pritet ratifikimi i marrëveshjes së re për sigurime shoqërore. Mbi 5000 kosovarë që kanë vendosur të kthehen në Kosovë pas dekadave të punës në Zvicër, ende nuk e kanë mundësinë e bartjes së përfitimeve në të cilat kanë të drejtë në rast të ndonjë rreziku, edhe pse rregullisht kanë paguar kontributet në arkat e sigurimeve shoqërore. Për më tepër, që nga e njëjta kohë nuk i'u paguhen as shtesat familjare dhe ato të fëmijëve të jetojnë në Kosovë.



Muaji qershor i vitit 2017, e pa arritjen e marrëveshjes për sigurime shoqërore në mes delegacioneve teknike të Kosovës dhe Zvicrës, duke dhënë shpresë se problemit shtatë vjeçar po i vie fundi. Por, derisa ende mbeten shumë paqartësi se kur marrëveshja bilaterale do të ratifikohet, sindikalistët dhe aktivistët nga diaspora vazhdojnë të kenë pikëpyetje për rolin e qeverisë së Kosovës për ta çuar procesin përpara. Invalidët e punës, dhe qytetarët që kanë punuar me vite të tëra në Zvicër dhe që janë larguar nga ky vend para moshës së pensionimit, mbesin më të prekurit nga mos qasja në sigurimet shoqërore.

Në vitin 2010, shteti zviceran njoftoi se marrëveshja ndërshtetërore për sigurime shoqërore me ish-Jugosllavinë nuk do të zbatohet më në raport me Kosovën. Qëllimi i marrëveshjeve të tilla ndërshtetërore synon trajtimin e barabartë e njerëzve që banojnë në një vend dhe kryejnë veprimtari ekonomike në vendin tjetër. Kështu çdo person që kryen aktivitet ekonomik në Zvicër i nënshtrohet një sigurimi shoqëror në përputhshmëri

me legjislacionin e vendit. Për shembull, nëse një punëtor në rast të një invaliditeti ose rreziku tjetër nuk ka mundësi të vazhdojë aktivitetin ekonomik ai ka të drejtën në përfitime si formë pensioni, që bartet në vendin amë apo në cilindo vend tjetër të botës ku personi vendos të kthehet. Zvicra ka të nënshkruara mbi 40 marrëveshje me BE-në dhe shtetet e krijuara nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë duke i garantuar të gjithë qytetarët e këtyre vendeve të kenë të drejtën në eksportimin e përfitimeve në fjalë nëpër gjithë botën.

Marrëveshja Kosovë-Zvicër, e njohur ndryshe si 'marrëveshja në mes të pensioneve, u ndërpre me 1 prill të vitit 2010 duke i'u shkelur të drejtën shumë kosovarëve të marrin pensionin, dhe përfitime tjera nga sigurimet shoqërore. Ndërprerja e marrëveshjes kryesisht ka qenë rezultat i lobimit të Partisë Popullore Zvicerane (SVP), për t'i dhënë fund marrëveshjeve të sigurimeve shoqërore me vendet e ish-Jugosllavisë. Partia popullore e djathtë, e zëshme në avokimin kundër imigrantëve e bazonte presionin e vet politik duke u thirrur në keqpërdorime të pensionit të invaliditetit nga punëtorët mërgimtarë. Në fakt SVP-ja asnjëherë nuk kishte arritur t'i dëshmojë këto keqpërdorime.

Gjatë këtyre viteve, përkundër kërkesave të shumta të qytetarëve të dëmtuar, zëri i të cilëve shpesh është përfaqësuar nga aktivistët e diasporës, e në veçanti nga sindikalistët e UNIA-s – Sindikatë për të drejtat e punëtorëve me bazë në Zvicër – Qeveria e Kosovës kishte ngecur ta trajtojë si prioritet përtëritjen e marrëveshjes së re. Vetëm pas shtatë viteve, delegacionet

teknike të Kosovës dhe Zvicrës përfunduan negociatat dhe miratuan tekstin final të marrëveshjes bilaterale për sigurimet sociale. Madje, ndër vite ishin sindikalistët e UNIA-s ata të cilët morën edhe barrën e informimit mbi çdo proces të marrëveshjes, ose në formë të komunikatave për media, apo tubimeve informuese.

Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka shkaktuar zemërim të aktivistëve mërgimtarë, duke dështuar të përfshijë ekspertë të diasporës si bashkëpunëtorë gjatë procesit të negociatave me shtetin zviceran. Ndërkohë, anëtarë të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale po ashtu kanë kritikuar qeverinë që nuk po shpërfill rekomandimet e ndryshme në lidhje me marrëveshjen të nxjerra nga legjislatura e katër të Kuvendit të Kosovës.

Edhe pse në qershor Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale pati deklaruar se do të vazhdojë të punojë me ritëm të shpejtuar që kjo marrëveshje të kalojë procedurat e nevojshme dhe të ratifikohet sa më shpejtë, data e hyrjes së marrëveshjes në fuqi vazhdon të jetë pikëpyetje.

Ky editoriali është shkruar si rezultat i diskutimit virtual me akterët kryesor në procesin e marrëveshjes për sigurime sociale, të organizuar nga organizata Germin, e cila shpesh përdor kanalet virtuale për të përfshirë diasporën në proceset e demokratizimit të vendlindjeve të tyre në Ballkanin perëndimor.

Diskusimin virtual mund ta ndiqni në vegën vijuese:

https://www.youtube.com/watch?time_continue=117&v=5LgtoH3Zy0U

Nga: Dafina Halili

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Parat e kompensimit të papunësisë: Arka e papunësisë ka gabuar – a duhet të gjobitem unë për këtë?

Unë jam e huaj dhe kam studiuar në Universitetin e Cyrihut deri në vitin 2016. Pas studimeve nuk kam mundur të gjej menjëherë një vend pune, andaj jam lajmëruar tek Arka e sigurimit të papunësisë dhe kam marrë kompensimin e parave në rast papunësie. Tani kam marrë një vendim. Arka e sigurimit të papunësisë donë t'ia kthejë shumën prej 3500.– frangave. Ajo arsyeton se unë nuk jetoj që 10 vite në Zvicër deh për këtë arsye nuk kam të drejtë në kompensim nga Arka e sigurimit të papunësisë. Ata nuk e kanë vë re këtë fakt me rastin e shqyrtimit të aplikimit tim. Në ndërkohë unë prapë jam i papunë dhe edhe përkundër dëshirës nuk kam mundësi të kthej parat e marra si kompensim nga Arka në fjalë. Çka mund të bëjë?

Mirjam Brunner: Mjereshtoj. Ligji i punës edhe pse e rregullon kohëzgjatjen e pauzave, nuk rregullon pagesën. Pra i mbetet punëdhënësit tuaj të vendosë se a do ti paguajë pauzat apo jo. Ndryshe qëndron me ligj nëse nuk mund të vendosni për pauzat tuaja, fjala bie, kur nuk mund të largoheni nga vendi juaj i punës dhe në rast se edhe më tej duhet të jeni të arritshëm në telefon. Një pauzë e tillë mund ti shërbejë të ushqyerit dhe pushimit nga puna e drejtpërdrejtë, mirëpo nuk ofron çlodhje. Në raste të tilla pauza numërohet si orar pune. Ligji i punës parashkruan pauzat duke pasur parasysh mbrojtjen e shëndetit. Ato janë të rëndësishme për të shmangur mbingarkesat dhe rreziqet e aksidenteve në punë që mund të rrjedhin nga ato. Koha minimale e pauzave llogariten bazuar në kohëzgjatjen e orarit të punës: pas 5 orë e gjysmë është e detyrueshme një pauzë një çerek ore (15 minutash), pas 7 orë punë duhet pauza gjysmë ore, ndërsa pas 9 orësh punë duhet bërë një pauzë një ore.

1 dhjetor 2017

Paga e papaguar: A mund ta ndërpres punën?

Sipas Kontratës sime të punës punëdhënësi im më ka borxh rrogën time për në fund të muajit. Edhe pse qysh në vitin e kaluar disa herë më është vonuar rroga, deri më sot nuk më është paguar rroga e muajit dhjetor. Kam dëgjuar se në rast të tillë të mospagimit të rrogës mund ta ndërpres punën dhe megjithatë të më takoj paga. A qëndron kjo?

MYRIAM MUFF: Po. Sipas praktikës juridike të gjyqit federal në parim mund të refuzohet puna, nëse punëdhënësi vonohet të paguajë rrogën. Me këtë rast edhe më tej mbetet e drejta e pagës, pa u obliguar punëdhënësi që të kompensojë punën e refuzuar për shkak të vonësës së rrogës. Duhet pasur kujdes, nëse është fjala për shumë të vogla parash (fjala bie nën 200 franga). Në rate të tilla ekziston rreziku që gjyqi më pastaj të mos i japi të drejtë refuzimit të punës. Mirëpo, para se të ndërprisni punën, duhet ti tërhiqni vërejtjen punëdhënësit me shkrim së paku një herë dhe t'ia përcaktoni afatin e pagesës prej 3-5 ditë. Pos kësaj duhet t'ia komunikoni punëdhënësit se pas kalimit të afatit do të ndërprisni punën.

work, 19 janar 2018

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber: Verlagsgesellschaft work AG, Zürich | Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne | Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano | Chefredaktion: Gianfranco Helbling | Redaktionskommission O. Osmani, E. Sariastan, D. Filipovic, M. Martin, M. Mendes | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout I. Schmieder, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch
www.unia.ch

UNIA